

RAPORT VJETOR 2024



“ATLANTIK” sh.a. - SHOQËRI SIGURIMESH



FUQIA JUAJ E SIGURIMEVE!





SIGURIMI I BIZNESIT

FUQIA JUAJ E SIGURIMEVE



atlantiksha



atlantik sh.a



Atlantik sh.a

I interesuar për siguracion?

t: +355 4 2 230 506

c: +355 68 206 8000

e: info@atlantik.al

P Ë R M B A J T J A

1. Informacioni rreth shoqërisë

- 1.1 Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm 5
- 1.2 Misioni, vizioni dhe filozofia e shoqërisë 7
- 1.3 Objektivat Kryesore të Veprimtarisë së Biznesit që u orientuam për 2023: 8
- 1.4. Struktura qeverisëse 9

2. Treguesit kryesor të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2024

10

- 2.1 Informacion i përgjithshëm i tregut të sigurimeve
- 2.2. Treguesit kryesor të aktivitetit të shoqërisë gjatë vitit 2024
- 2.3 Politika e pranimi dhe menaxhimit të rrezikut

3. Raporti i Audituesit të Brendshëm

21

- 3.1. Veprimtaria e Auditit të Brendshëm
- 3.2. Opinioni Audituesve të Brendshëm
- 3.3 Pavarësia e Auditit



SIGURIMI I GARANCISË SË OFERTËS

FUQIA JUAJ E SIGURIMEVE



atlantiksha



atlantik sh.a



Atlantik sh.a

I interesuar për siguracion?

t: +355 4 2 230 506

c: +355 68 206 8000

e: info@atlantik.al

MESAZH I DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM

Të nderuar miq të ATLANTIK!

Si zakonisht, me këtë letër hapëse për Raportin, dëshirojmë t'ju paraqesim një përmbledhje të shkurtër të dymbëdhjetë muajve të fundit.

Në botën e sotme të ndërlidhur, asnjë kompani nuk mund të izohet vërtet nga ajo që po ndodh në pjesët e tjera të botës politikisht, ekonomikisht ose teknologjikisht. Në vitet e fundit, tregjet globale janë përballur me pasiguri në rritje ku janë shtuar dhe shqetësimet që vijnë nga frontet e luftës. Ndërsa inflacioni tregoi shenja ngadalësimi falë normave më të ulëta, politikave monetare më të shtrënguara dhe një rënije të çmimeve të energjisë, rreziqet e një rritjeje të re të presionit mbi çmimet mbetën të konsiderueshme. Në këtë sfond, sektori i sigurimeve përfitoi nga kapitalizimi i fortë dhe tregoi rritje të qëndrueshme, kryesisht të nxitur nga dixhitalizimi dhe miratimi i politikave që lidhen me mbrojtjen nga rreziqet klimatike.

Kryefjala e ekonomisë shqiptare gjatë vitit 2024 ishte “turizmi”. Siç dëshmohet, INSTAT konfirmoi se 11,7 milionë të huaj vizituan vendin gjatë vitit të kaluar me rritje prej 15,2% në krahasim me një vit më parë. Ky trend duket se i ka dhënë ekonomisë shqiptare një orientim të ri, pas vitesh të tëra të fokusuar vetëm në sektorë si ndërtimi, bujqësia apo shërbimet. Zhvillimi i turizmit po jep një kontribut kryesor në përmirësimin e ekonomisë shqiptare, sa u takon të ardhurave, punësimit dhe rritjes së konsumit në vend. Ishte pikërisht turizmi ai që ndikoi që 2024 të ishte një vit pozitiv për ekonominë shqiptare.

Nëse ka një sektor, ecuria e të cilit prek pothuajse të gjithë sektorët e tjerë të ekonomisë është “turizmi”. Shërbimet janë të lidhura me



Dritan ÇELAJ
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv

turizmin, investimet në infrastrukturë janë gjithashtu efekt i tij, industria ushqimore po ashtu ka lidhje të drejtpërdrejtë. Edhe tregu i sigurimeve nuk mbetet jashtë këtij cikli sepse *ku ka lëvizje dhe investime, ka nevojë për “siguri”*.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për vitin 2024 kapën vlerën 24,505 milionë lekë, ose 7,02% më shumë se në vitin 2023. Sipas Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF), gjatë vitit 2024, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1 595 687 me një rritje prej 8,84% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Tregu mbeti i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës me 91,51% të vëllimit të përgjithshëm të primeve ndjekur nga sigurimet e Jetës me 8,45% dhe risigurimi me 0,043%. Sigurimi vullnetar zuri 38,55% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm kanë 61,45% të totalit të tregut.

Miq të ATLANTIK! A e dini pse gjithë këto shifra?

Sepse në një ekonomi të orientuar gjithnjë e më shumë nga turizmi, sigurimi i pronës merr një vëmendje të veçantë. Hotelet, baret, restorantet deri edhe shtëpitë që jepen me qira ditore duhet të ndërjegjësohen se siguria është kryefjalë e turizmit. Biznesi shqiptar duhet të kuptojë se investimi i tyre duhet të ketë një mbrojtje që mbetet një garanci për të ardhmen. Qytetarët shqiptarë që udhëtojnë jashtë për pushime dhe që vitin e kaluat ishin jo pak, por 7.9 milionë udhëtime, kanë nevojë për sigurim shëndetësor për të qenë të sigurt.

ATLANTIK është këtu pikërisht për këtë!

Prej 24 vitesh, ATLANTIK u ka qëndruar besnike parimeve të saj duke vendosur interesin e klientëve në rend të parë. Në një shoqëri që rend pas teknologjisë ne jemi këtu për të ofruar siguri dhe përmbushje të çdo kërkesë që kanë klientët tanë.

Ne jetojmë në një botë të pasigurt plot sfida, por ajo që ka vërtet rëndësi është aftësia për t'u përgjigjur shpejt dhe me qetësi.

Në biznesin tonë, fleksibiliteti është thelbësor. Na mundëson t'i përgjigjemi rrethanave në ndryshim, duke siguruar vazhdimësi. ATLANTIK mbetet e përkushtuar që të ofrojë garanci dhe besueshmëri për të gjithë.

Ju falenderoj të gjithëve për bashkëpunimin!

MISIONI YNË

ATLANTIK numëron tashmë gati 2 dekada e gjysmë në tregun shqiptar privat të sigurimeve. Ka qenë një rrugë e gjatë e mbushur me sfida të rëndësishme, por me suksese kuptimplota. Kompania jonë numëron mbi 15 degë në mbarë Shqipërinë me mbi 150 punonjës, por mbi të gjitha: mbi 700 mijë klientë të kënaqur. Për më tepër, siguri financiare për të mbuluar dëmet e policave të firmosura me klientët tanë.

“Fuqia juaj e sigurimeve” është slogani që kompania jonë e ka kthyer në një mision të punës së saj të përditshme. Ne jemi të fokusuar në përbushjen e të gjitha kërkesave të çdo klienti që paraqitet në sportelet tona.

Sigurimi i pronës nga zjarret apo rreziqet e tjera, sigurimi i shëndetit në udhëtim, sigurimi nga aksidentet në punë, i studentëve që jetojnë jashtë vendit apo biznesit tuaj mbetet për ne jo vetëm një obligim, por edhe një kënaqësi. Gama jonë e shërbimeve është e shtrirë nga sigurimi i përgjegjësisë, siç janë ato profesionale, karburantet, garancitë e kontratave, sigurimi i mallit gjatë transportit në rrugë tokësore, detare apo dhe ajrore.

rëndësi edhe cilësisë së shërbimit. Ne kemi qenë dhe mbetemi të angazhuar në ofrimin e një shërbimi të bazuar tek integriteti dhe profesionalizmi.

Vizioni ynë

Vizioni i kompanisë ATLANTIK mbetet qasja sa më e shpejtë e zhvillimeve teknologjike. Synimi ynë është zgjerimi i mëtejshëm i paketave të shërbimeve për klientët tanë.

Duke qenë se në kompaninë tonë klienti është prioriteti “numër një” ne garantojmë që ai të gjejë një përbushje të plotë të kërkesave në përputhje me mundësitë. Klientët tanë janë edhe partnerët tanë. Ne synojmë gjithashtu të jemi një partner i besueshëm për ta. ATLANTIK synon të jetë një garanci për një të ardhme më të sigurt për të gjithë klientët tanë.

Vizioni ynë është forcimi i imazhit të një kompanie të besueshme që ofron garanci për të gjithë.

Faleminderit të gjithëve për besimin që na keni dhënë!





OBJEKTIVAT KRYESORE TË VEPRIMTARISË SË BIZNESIT U ORIENTUAN PËR 2024:

- Transformim të thellë të shumë aspekteve strukturore drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe inovacionit digjital.
- Sigurimin e produkteve, shërbimeve me profesionalizmin dhe etikën, duke i siguruar klientët për mbështetje në çdo kohë, **kompensim të plotë dhe të drejtë për dëmet**.
- Shërbime të orientuara në kërkesat e klienteve, mbështetur në filozofinë e vlerave, profesionalizmit, bazueshmërisë ligjore, reflektimit ndaj kërkesave të klientit dhe fokusimi tek ai.
- Planifikimi strategjik për rritjen e volumit të të ardhurave, duke synuar rritjen e vazhdueshme të ATLANTIK, struktura fleksible, rritjen e imazhit në publik me qëllim mbrojtjen e individëve, familjeve dhe bizneseve duke ndërtuar një të ardhme më të sigurt dhe më të qëndrueshme
- Monitorimi i vazhdueshëm i situatës dhe zbatimi i planeve për të minimizuar pasojat e pandemisë në aspektin financiar dhe efektet e mundshme, për vazhdimësinë e veprimtarisë së qëndrueshme të biznesit në situatën aktuale.
- Shoqëria bazuar në raportimet dhe treguesit e aftësisë paguese, rrugëtimi treguesit e mjaftueshmerise se kapitalit dhe stabilitetit financiar.
- Përmirësimi i cilësisë së punës së punonjësve, nëpërmjet përzgjedhjes, rekrutimit dhe trainimit të tyre si dhe përsosjen e metodës së shpërblimit për punën e bërë nga gjithsecili.
- Zbatimi i politikave të investimeve të shoqërisë me qëllim rritjen e vlerës së tyre.
- Hedhja në treg e produkteve nëpërmjet shitjeve on-line të cilat përmbushin nevojat e klienteve, në kushtet e pandemisë dhe distancimit social.



STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHOQËRISË ATLANTIK SH.A.

Per shkak te historikut te krijimit te saj, Shoqeria ATLANTIK sh.a eshte nje marke tregtare prej 23 vitesh ne tregun e sigurimeve shqiptare. Kompania në mënyrë të vazhdueshme ka forcuar drejtimin në stafin e saj duke zhvilluar një strukturë organizative sa më efeciente, elastike dhe optimale.

Strukturat pergjegjese per realizimin e objektivave janë:

- Këshilli Mbikëqyrës
- Drejtori i Pergjithshem,
- Komiteti i Auditimit dhe Administrimit te Riskut
- Departamentet, Drejtorite dhe sektoret ne Drejtorine e Pergjithshme,
- Drejtorite Rajonale ne Rrethe

Këshilli Mbikëqyrës i Shoqerise ATLANTIK

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Luan BREGASI | Kryetar |
| 2. Envi HICKA | Anëtar |
| 3. Aleksandër MUSKAJ | Anëtar |


TREGUESIT KRYESOR TË ZHVILLIMET E TREGUT TË SIGURIMEVE NË SHQIPËRI PËR VITIN 2024 SIPAS PUBLIKIMEVE TË AMF-SË: _____

1. Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit Jo-Jete për vitin 2024 kapën vlerën mbi 22,424,920 lekë ose 6.66% më shumë se viti 2023.
2. Numri i kontratave arriti në 1,442,920 duke shënuar një rritje me 8.38 % krahasuar me vitin 2023.
3. Tregu ne vend mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat perbejne 91.5% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës me 8.5%.
4. Ndarja e tregut sipas llojit të sigurimit, rezultoi: primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 32.85% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 67.15% të totalit të tregut.
5. Gjatë vitit 2024, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,294,455 mijë lekë, ose një rritje prej 24.87% më shume se viti 2023.
6. Sigurimi i Detyrueshme Motorik, gjatë 2024 arriti rreth 16,821,181 mijë lekë, ose 8.77% më shumë se viti 2023.
7. Produkti DMTPL, rezultoi me rritje prej 9.27% të volumit të primeve të shkruara bruto, dhe një rritje të numrit të kontratave prej 16% krahasuar me vitin 2023.
8. Sigurimet Vullnetar, gjatë vitit 2024 arritën rreth 7,365,670 mijë lekë, dhe perbejne 32,85% ndaj totalit te te ardhurave te gjithë tregut jo jete.
9. Në portofolin sigurimi nga Zjarri dhe Forcat e Natyrës, gjatë vitit 2024, vihet re një rritje e sigurimeve te proneve prej 4.15% e volumit të primeve të shkruara bruto të këtij portofoli krahasuar me vitin 2023.
10. Të ardhurat nga sigurimet e Aksidenteve, gjatë vitit 2024, arritën në rreth 1,392,400 mijë lekë, duke shënuar një rritje prej 1.5% në krahasim me vitin 2023 dhe te Shendetit ne Udhetim shenuan një renie prej 12.24% gjatë vitit 2024 në krahasim me vitin 2023.
11. Sigurimi e Përgjegjësiwe Civile gjatë vitit 2024 pati një rrenie prej 9.86% të volumit të primeve të shkruara bruto, e krahasuar me vitin 2023.
12. Primet e Shkruara Bruto në Sigurimin e Përgjegjësiwe në Ndërtim gjatë vitit 2024, pati një ulje prej 26.04% të volumit të primeve të shkruara bruto, krahasuar me vitin 2023.
13. Pagesat e Dëmet e Paguara Bruto gjate vitit 2024 u rriten me 26.24% krahasuar me vitin 2023. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit nga Sigurimi Motorik me rreth 4,267 milionë lekë, apo 54.3% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

TREGUESIT KRYESOR TË AKTIVITETIT TË SHOQËRISË ATLANTIK 2024

Analiza e rezultateve të Shitjeve për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023:

- ✓ ATLANTIK ka rritje të ardhurave në vitin 2024 me 7.43% duke përbërë 6.15% të tregut të Sigurimeve, kundrejt 6.11% në vitin 2023.
- ✓ Duke krahasuar ecurinë e tregut të sigurimeve në vend që rezultoi me një rritje prej 6.66% për gjithë tregun e sigurimeve Jo-Jete sipas AMF (Raporti Janar – Dhjetor 2024).
- ✓ Kompania ATLANTIK në numër kontrata ka realizuar 87,276 me një realizim prej 106% në krahasim me Vitin 2023.




Kontributin kryesor në realizimin e të ardhurave për vitin 2024 e zënë: Sigurimet Motorike përbejnë 84% të totalit të primeve:

- TPL 77%
- Kasko 3%
- Kufitare 3.6%

Sigurimet Vullnetare përbejnë 16% të totalit të primeve:

- Sigurimi Zjarri etj. 9.2%
- Sigurimi Pergjegjesise 3.77%
- Aksidente Pers. & SHU 1%
- Sigurimi Garancive 1.7%



Viti 2024, rezultoi me rritje në prime ne pjesen me te madhe te produkteve te sigurimeve vullnetare pervec:

- Sigurimeve te Pergjegjesise se Ndertimit, produkti i cili rezulton me ulje per gjithe tregun prej 26%,
- Sigurimeve e mallit, aksidenteve personale, marines etj.. Poziconi shoqerise atlantik sh.a ne tregun e sigurimeve:
- ATLANTIK perben 6.88% per 2024 te tregut te Sigurimeve te Motorik, e fundit ne treg.
- ATLANTIK perben 2.34% per 2024 te tregut te Sigurimeve te Kaskos, e fundit ne treg.
- ATLANTIK perben 10% per 2024 te tregut te Sigurimeve te Kufitare, e pesta ne treg.

Produktet te cilat rezultojn me rritjen 105% ne volum primesh ne grupin e Sigurimeve te Pasurise krahasuar me vitin 24/23:

- ✓ Sigurimi i Prones ka rritje ne prime me 116% ne krahasim me 2023.
- ✓ Sigurimi i Prones, per 2024 perben rreth 57% te te ardhurave nga sigurimet vullnetare
- ✓ ATLANTIK perben 4.96% te tregut ne vend dhe renditet kompania 6 duke lene pas dhe 2 kompani te tjera – sipas AMF.

Shperndarja Gjeografike ne 2024 per Shoqerine ATLANTIK rezulton si meposhte:

SHPERNDARJA GJEOGRAFIKE	PRIME TOTAL 2024	% ne Totalin e Primeve Respektive	2024		% ne Totalin e Primeve respektive	
			SIGURIMI I DETYRUESHEM	SIGURIMI VULLNETAR	SIGURIMI I DETYRUESHEM	SIGURIMI VULLNETAR
TIRANA	854,219,631	61%	686,381,891	167,837,741	63%	62%
DEGET NE RRET	538,146,755	39%	411,426,613	103,008,477	37%	38%
TOTAL	1,392,366,386	100%	1,097,808,504	270,846,218	100%	100%

- ✓ Ne Tirane realizohen rreth 61% e te ardhurave te shoqerise
- ✓ Ne Deget ne Rrethe realizohen rreth 39% e te ardhurave.



RSM ALBANIA
Rr.Skender Luarasi, sheshi Gjenerali
Jozef San Martin, Pallati 3Hyrja 19,
Tiranë, Shqipëri
T: +355 69 706 6110
www.rsm.global/albania

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Drejtimin dhe Personat e Ngarkuar me Qeverisjen e Atlantik – Shoqeri Sigurimesh sh.a.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Atlantik – Shoqeri Sigurimesh sh.a. ("Shoqëria"), që përfshijnë pasqyrën e të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2024, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, si dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, dhe performancën financiare dhe fluksin e mjeteve monetare për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin Ndërkombëtar të Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës të Kontabilistëve Profesionistë (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë) (Kodi i BSNEKP) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEKP.


Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje tjetër

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 janë audituar nga një auditues tjetër i cili ka shprehur një opinion pa rezerva mbi ato pasqyra financiare në 30 prill 2024.

THE POWER OF BEING UNDERSTOOD ASSURANCE | TAX | CONSULTING

RSM Albania SH.P.K is part of the RSM network and trades as RSM. RSM is the trading name used by the members of the RSM network. Each member of the RSM network is an independent accounting and consulting firm, which practices in its own right. The RSM network is not itself a separate legal entity in any jurisdiction.



Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me bazat e përgatitjes siç tregohet në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare individuale, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.


Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa një që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehtë, falsifikim, mosdhënie e vetëdijshme e gjithë informacionit, keq-përfaqësime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të lidhur me auditimin me qëllim hartimin e procedurave të auditimit të cilat janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël dhe informacioneve të lidhura shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- Duke u bazuar në evidencat e auditimit, nxjerrim përfundime mbi përshtatshmërinë e përdorimit nga ana e drejtimit të parimit të vijimësisë si bazë kontabël, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse në aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit tek informacionet shpjeguese të pasqyrave financiare ose nëse këto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të ndryshojmë opinionin tonë. Përfundimet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të shkaktojnë që Shoqëria të ndalojë së vazhduari në vijimësi.



- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin veprimet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojmë me Drejtimin dhe personat e ngarkuar me qeverisjen e Shoqërisë, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Raport për Informacione të Tjera

Informacione të tjera përfshijnë informacione përgatitur në përputhje me Ligjin numër 25\2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera të Shoqërisë për vitin 2024 pritet të na vihen në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit. Opinioni ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione. Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuara më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me gabime materiale. Nëse bazuar në punën e kryer ne arrijmë në përfundimin se këto informacione përmbajnë gabime materiale, atëherë ne duhet të raportojmë për këtë fakt.


Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare të Aftësisë Paguese dhe Aktivitet për Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit ("anekse shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2024, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Bujar Bendo
Auditues Ligjor

RSM Albania

Tiranë, 28 prill 2025



Atlantik – Shoqeri Sigurimesh sh.a.

(Të gjitha shumat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar më 31 dhjetor 2024

	Shënime	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
AKTIVE			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	7	30,875,031	30,947,056
Depozita me afat me bankat	8	1,026,864,252	912,236,121
Të arkëtueshme nga kontrata e sigurimit	9	160,871,430	164,913,126
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	10	266,079,004	280,003,276
Aktive të risigurimit	11	10,222,472	11,080,031
Investime në pasuri të paluajtshme	12	368,206,697	380,847,628
Aktive afatgjata materiale	13	153,918,112	131,097,106
Aktive afatgjata jo-materiale	14	6,156,140	5,037,113
E drejta e përdorimit të aseteve	15	105,102,248	14,079,220
Parapagime ndaj paleve të lidhura	16	157,692,232	140,353,179
Aktive të tjera	17	305,389,784	230,955,062
Totali i Aktiveve		2,591,377,402	2,301,548,918
DETYRIMET			
Detryrime për humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	18	298,581,656	290,154,822
Rezerva për primet e pafituara	19	904,543,960	818,840,427
Detryrime ndaj risiguruesit	20	11,932,384	11,709,301
Detryrime nga qiraja	22	113,574,058	15,963,465
Detryrime tatimore	23	6,610,437	14,118,768
Llogari të pagueshme nga sigurimi dhe të tjera	21	61,600,531	52,494,825
Provizione të tjera në lidhje me sigurimet	24	38,000,000	38,000,000
Rezerva për fond kompensimi	25	48,565,430	52,881,753
Totali i detyrimeve		1,483,408,456	1,294,163,361
KAPITALI			
Kapitali themeltar	26	827,469,281	827,469,281
Rezerva të rrezikut të pasiguruar	27	17,787,665	17,787,665
Fitim/ humbjet e mbartura		112,128,611	55,518,756
Fitimi i vitit		150,583,389	106,609,855
Totali i kapitalit		1,107,968,946	1,007,385,557
Totali detyrimeve dhe kapitalit		2,591,377,402	2,301,548,918

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Atlantik – Shoqëri Sigurimesh sh.a.

(Të gjitha shumat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital

	Kapitali themeltar	Rezerva	Fitime / (humbje) e mbartur	Fitim/ humbje e vitit	Totali
Gjendja më 1 janar 2023	827,469,281	17,787,665	12,672,074	82,846,682	940,775,702
Fitim i vitit	-	-	-	106,609,855	106,609,855
Dividend	-	-	(40,000,000)	-	(40,000,000)
Transferimi ne fitime te mbartura	-	-	82,846,682	(82,846,682)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	827,469,281	17,787,665	55,518,756	106,609,855	1,007,385,557
Fitim i vitit	-	-	-	150,583,389	150,583,389
Dividend	-	-	(50,000,000)	-	(50,000,000)
Transferimi ne fitime te mbartura	-	-	106,609,855	(106,609,855)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2024	827,469,281	17,787,665	112,128,611	150,583,389	1,107,968,946

Shënimetshpjeguese nga faqja 5 deri në 43 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga bordi drejtues i Shoqërisë më 7 prill 2025, dhe janë firmosur në emër të tij nga Drejtori i Përgjithshëm dhe Drejtori Departamentit të financës:



Dritan Çelaj
Drejtori i Përgjithshëm

Juljana Kupi
Drejtore Departamentit të Financës

Atlantik – Shoqeri Sigurimesh sh.a.

(Të gjitha shumatat janë në Lek përveç rasteve kur është shprehur ndryshe)

Pasqyra e Flukseve të Parasë

Shënimi	31 dhjetor 2024	31 dhjetor 2023
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi para tatimit	188,626,053	139,005,702
Rregullime për;		
Amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve afat-gjata	51,207,597	43,265,457
Të ardhura nga interesi	(17,320,124)	(5,716,481)
Fluksi i mjeteve monetare nga aktivitetet operative para ndryshimit në aktivet dhe detyrimet operative	222,513,526	176,554,678
<i>Ndryshimi në aktivet dhe detyrimet operative</i>		
Ndryshimi në llogarite e arketueshme të sigurimit	4,041,696	5,477,999
Ndryshimi në shpenzimet e shtyra të marrjes së sigurimit	13,924,272	(55,194,306)
Ndryshimi në aktivet e risigurimit	857,559	2,357,948
Ndryshimi në parapagime ndaj palëve të lidhura	(17,339,054)	(14,360,553)
Ndryshimi në aktive të tjera	(74,434,720)	(70,462,291)
Ndryshimi në rezervën teknike për dëme	85,703,534	(9,458,831)
Ndryshimi në rezervën e primit	8,426,835	98,541,880
Ndryshimi në detyrimin nga risiguruesi	223,083	(4,335,338)
Ndryshimi në detyrimet nga sigurimi dhe të tjera	4,789,383	(809,970)
Interesi i arkëtuar	13,360,405	6,686,303
Flukse monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	262,066,519	134,997,519
Tatimi i paguar mbi fitimin	(45,550,995)	(31,529,536)
Flukset monetare neto gjeneruar nga aktivitetet operative	216,515,524	103,467,983
Flukset monetare nga aktivitetet investuese		
Blerje neto aktive afatgjata	(38,120,616)	(7,003,118)
Rritje në depozitat me afat	(110,668,410)	(33,980,507)
Mjete monetare neto përdorur nga aktivitetet investuese	(148,789,026)	(40,983,625)
Flukset e parasë nga aktivitetet financuese		
Detyrimi i qirase	(17,798,523)	(17,790,357)
Dividente	(50,000,000)	(40,000,000)
Flukse monetare neto të gjeneruara nga aktivitetet financuese	(67,798,523)	(57,790,357)
Rritja neto në mjetet monetare	(72,025)	4,694,001
Mjete monetare në fillim të vitit	30,947,056	26,253,055
Mjete monetare në fund të vitit	30,875,031	30,947,056

7

Shënimet shpjeguese nga faqja 5 deri në 43 janë pjesë përbërëse ekëtyre pasqyrave financiare.

Raporti i Aktiveve në mbulim të Provigjoneve Teknike për vitin e mbyllur me 31.12.2024

IV	TOTALIIINVESTIMEVE(I+II+III)		1,563,430,578	
V	TOTALIIINVESTIMEVETELEJUARA(Totali i"Vleranëfakt"zbritur"Investimembilimitete lejuara")		1,317,180,811	-
VI	C.Provigjoneteknike,të ndryshmengaato matematike,bruto(VI.1deriVI.5)		1,203,125,617	
VI.1	Provigjonetëprimittëpafituar		904,543,960	
VI.2	Provigjonetëdëmeve		298,581,657	
VI.3	Provigjonepërbonusedherabate			
VI.4	Provigjonebarazimidhekatastrofe			
VI.5	Provigjone tëtjrateknike			
VII	Tepricë(+)/Mungesë(-)(V-VI)		114,055,194	
VIII	Mbuliminë%(V/VI)		109.48%	

Raporti "Aktive në mbulim të provigjoneve teknike" është një tregues financiar shumë i rëndësishëm për kompanitë e sigurimeve. Ai tregon aftësinë e kompanisë për të mbuluar detyrimet e saj teknike (provigjionet teknike) me aktivet që ka në dispozicion, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullatore. Detyrimi ligjor është masa 100% e këtij raporti.

Atlantik për vitin 2024 ka një raport 109.48%. Ky është një tregues pozitiv, që flet për likuiditet të mirë, stabilitet dhe përputhshmëri me kërkesat ligjore. Në analizat financiare dhe auditimet një vlerë e tillë konsiderohet e sigurt dhe optimale.

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit për vitin e mbyllur me 31.12.2024

VI	KAPITALI(AftësiaPagueuse)	602,349,523
VII	Kufiriminimaliaftesisëpaguese,sipaspikës3tënenit80 tëLigjitNr.52/2014	241,302,631
VIII	Fondiigarancisë,sipasnenit81tëLigjitNr.52/2014	370,000,000
IX	Niveliikërkuariaftësisëpaguese,sipaspikës2tënenit 80tëLigjitNr.52/2014	370,000,000
X	Mbi(+)/nën(-)nivelinekërkuartëAftësisëpaguese (VI-IX)	232,349,523
XI	Mjaftueshmëriaekapitalit	Imjaftueshëm

RAPORT VJETOR - 20

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit është një tregues kyç i shëndetit financiar dhe stabilitetit të një shoqërie sigurimi.

Ai krahason kapitalin real të disponueshëm të kompanisë me kapitalin minimal të kërkuar rregullator për të përballuar humbjet potenciale që mund të ndodhin nga ekspozimet ndaj rreziqeve të ndryshme (si rreziku i nënshkrimit, rreziku i tregut, rreziku operativ, etj).

Në Shqipëri dhe në Bashkimin Evropian (në përputhje me Solvency II), ky raport duhet të jetë minimumi 100%.

Atlantik zotëron kapital të disponueshëm që është 232,349,523 Leke më shumë se minimumi i kërkuar nga autoritetet rregullatore për të mbuluar rreziqet që ka marrë përsipër. Ky është një tregues shumë pozitiv i fuqisë financiare dhe stabilitetit të brendshëm të shoqërisë së sigurimit.

Kjo do të thotë se Atlantik financiarisht është qëndrueshëm dhe ka një “buffer” të mirë sigurie. Mund të përmbushë detyrimet e saj në rast humbesh të papritura.

Raporti i Likuiditetit gjatë gjithë vitit 2024 ka qënë mbi 100% në përputhje me rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit nr. 56, datë **28.04.2016** mbi “Administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e Sigurimit dhe Risigurimit”.

RAPORTI I AUDITUESVE TË BRENDSHËM

Shoqeria e sigurimeve Atlantik sh.a



VEPRIMTARIA E AUDITIT TË BRENDSHËM

Auditi i Brendshem gjate vitit 2024 ka funksionuar ne perputhje me parimet e pavaresise, objektivitetit dhe integritetit profesional. Rezultatet e arritura kane kontribuar ne:

- Forcimin e kultures se kontrollit dhe perputhshmerise brenda Shoqerise ATLANTIK;
- Mbeshtetjen e menaxhimit ne identifikimin dhe trajtimin e riskut;
- Rritjen e besueshmerise dhe transparences ne operacione.

Vazhdimi i permiresimit te funksionit te auditimit te brendshem, permes rritjes se kapaciteteve, dixhitalizimit dhe shkembimit te pervojes, perben nje prioritet per vitin 2025 dhe me tej.

Auditimet kryesore te realizuara per vitin 2024 perfshijne:

- Auditimin e ciklit te demshperblimeve, me fokus afatet e trajtimit dhe pagesave;
- Auditimi proceseve financiare dhe kontabilitetit lidhur me pagesat qe burojne nga kontratat e sigurimit dhe risigurimit si dhe pagesat qe lindin nga detyrimet shteterore per taksa/kontribute etj.
- Vleresimine funksionit te perputhshmerise me aktet e brendshme te Shoqerise dhe rregulloret apo udhezimet e Autoritetit procedurave te ndjekura nga departamenti shitjes dhe marrjes ne sigurim.
- Auditimin e sistemeve te informacionit dhe sigurise se te dhenave etj.

OPINIONI AUDITUESVE TE BRENDSTEM PAVARESIA E AUDITIT

Në bazë të evidencave të mbledhura dhe analizave të kryera gjatë auditimeve, vlerësojmë se:

Kontrollet e brendshme të Shoqërisë së Sigurimeve Atlantik sh.a janë në përgjithësi të përshtatshme dhe efektive.

Pavarësisht disa gjetjeve të natyrës së mesme dhe të ulët të riskut, nuk u evidentuan problematika që çenojnë ndjeshëm integritetin financiar apo përputhshmërinë ligjore të veprimtarisë së shoqërisë.

Audituesit e brendshëm sugjerojnë që shoqëria të përqendrohet më tej në përmirësimin e sistemeve dixhitale dhe automatizimin e proceseve të kontrollit.

Raporti i Likuiditetit gjatë gjithë vitit 2024 ka qenë mbi 100% në përputhje me rregulloren e miratuar me vendimin e Bordit nr. 56, datë 28.04.2016 mbi "Administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e Sigurimit dhe Risigurimit"

Auditimi është një funksion thelbësor për sigurimin e besueshmerisë së informacionit financiar dhe për garantimin e kontrollit të brendshëm në çdo institucion financiar, përfshirë edhe shoqëritë e sigurimeve. Pavaresia e auditit është një nga shtyllat kryesore që përcakton efektivitetin dhe besueshmerinë e auditimit. Në kontekstin shqiptar, kjo pavaresi sfidohet nga disa faktore, përfshirë ndikimin e pronesisë, marrëdhëniet menaxheriale dhe rregulloret ligjore.

Aktiviteti i auditimit të brendshëm ka qenë i pandikuar nga ndërhyrje për mënyrën e organizimit, si dhe nga çdo ndërhyrje në lidhje me përcaktimin e qëllimit, procedurave, shpeshtësisë së kontrollit, apo përmbajtjen e raportit të auditimit. Audituesi i brendshëm nuk ka pasur asnjë përgjegjësi ose përfshirje direkte në operacionet e Shoqërisë, të cilat janë ose mund të jenë subjekt i auditimit të brendshëm. Për rrjedhojë, audituesi



i brendshëm nuk ka përgatitur të dhëna financiare, ose ndërmarrë iniciativa dhe aktivitete të cilat do të binin ndesh me rolin e tij duke cënuar pavarësinë në gjykim dhe interpretimin e të dhënave të auditimit.

Auditi i Brendshëm konfirmon se pavarësia e aktivitetit të Auditimit të Brendshëm nuk është cënuar. Punonjësit kanë kryer detyrat e tyre me objektivitet, paanësi, pavarësi, angazhim të pandikuar nga rrethanat personale, familjare ose lidhjet shoqërore dhe ata sigurojnë që informacioni i paraqitur është i plotë dhe i saktë. Audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka shfaqur nivel të lartë të gjykimit profesional dhe objektiv në mbledhjen, vlerësimin dhe komunikimin e informacionit mbi proceset, të cilat kanë qenë subjekt auditimi. Njëkohësisht, audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka ushtruar një gjykim të balancuar duke shqyrtuar të gjithë rrethanat e dukura dhe nuk është influencuar nga interesi personal.

Objektivat strategjike për vitin 2025:

- ✓ Forcimi i kuadrit të administrimit të rreziqeve;
- ✓ Forcimi sigurise kibernetike;
- ✓ Përmirësimi i raportit të produkteve vullnetare;
- ✓ Pagesa e shpejtë e dëmeve;
- ✓ Arritja e një pozicioni të qëndrueshëm në tregun e sigurimeve.
- ✓ Përmirësimi i imazhit dhe standarteve.
- ✓ Raportimi pasqyrave financiare sipas standartit të ri IFRS17.

ATLANTIK





www.atlantik.al

Drejtoria Qendrore: Rr."Themistokli Gërmenji", 3/1, Tiranë, NIPT nr. K11807008V,
Tel./Fax (04) 235088, Tel. (04) 230 506,
Email: info@atlantik.al, www.atlantik.al